



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



**KOMUNA E PRIZRENIT**  
Opstina Prizren  
Prizren Belediyesi

---

# **PROPOZIMI I BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 2016 -2018**

**PRIZREN, SHTATOR 2015**

## PROPOZIM BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2016-2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale neni 24, Ligjin për Financa Lokale Neni 7 dhe 8 si dhe në Ligjin mbi menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë neni 55, 56, 57,59 dhe 60.

Dhe duke u bazuar në qarkoret gjegjëse nga MEF-i dhe në kornizën afatmesme të buxhetit 2016-2018 është hartuar propozimi përfundimtar i Buxhetit komunal për vitin 2016-2018, të cilin Kryetari pas shqyrtimit propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Asamblesë Komunale për miratim final në afatin e paraparë me ligj (30.09.2015).

### TË HYRAT E BUXHETIT KOMUNAL 2016

		<b>Aprovimi 2015</b>	<b>Planifikimi 2016</b>	<b>%</b>	<b>Ind</b>
Granti i përgjithshëm	Administrata	14,356,806	13,260,777		
	Arsimi	12,535,636	13,632,521		
	Shëndetësia	4,203,276	4,203,276		
<b>Subtotali</b>		<b>31,095,718</b>	<b>31,096,574</b>	<b>77</b>	<b>100</b>
Të hyrat vetjake Komunale	Administrata	7,825,080	9,030,000		
	Arsimi	250,000	250,000		
	Shëndetësia	200,000	200,000		
<b>Subtotali</b>		<b>8,275,080</b>	<b>9,480,000</b>	<b>23</b>	<b>115</b>
<b>Buxheti Komunal prej dy burimeve</b>		<b>39,370,798</b>	<b>40,576,574</b>	<b>100</b>	<b>103</b>

Buxheti Komunal përbëhet prej tri granteve kryesore:

- Granti i përgjithshëm për Administratë ,
- Granti specifik për Arsim dhe
- Granti specifik për Shëndetësi.

Nga Buxheti Qendror i Kosovës, për vitin 2016 parashikohet një Grant prej 31,096,574 € Granti Qeveritar për komunën tonë për vitin 2015 ka qenë 31,095,717 €, Granti nga Buxheti Qendror i Kosovës në totalin e Buxhetit Komunal merr pjesë me 77 % .

Burimi i dytë i Buxhetit Komunal janë të Hyrat vetjake që vilen nga tatimi në pronë, taksat dhe ngarkesat e ndryshme, gjobat në trafik dhe të hyrat që realizohen në Shëndetësinë Primare dhe në Arsim. Për vitin fiskal 2016 parashikohet që këto të hyra të arrijnë shumën prej 9,480,000 €e që është 15 % më shumë se planifikimi në vitin 2015 (8,275,080 €). Të hyrat vetjake komunale marrin pjesë me 23 % në totalin e Buxhetit Komunal.

Totali i Buxhetit Komunal për vitin fiskal 2016 është 40,576,574 € ka një rritje prej 1.205.777 € në krahasim me Buxhetin e planifikuar të vitit paraprak (39,370,797 €).

## TË HYRAT E BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 2017-2018

Granti Qeveritar për Komunën tonë për vitin 2017 parashikohet të jetë 31,167,197 € dhe 31,497,318 për vitin 2018 . Të Hyrat vetjake Komunale në vitin 2017-2018 do të jenë në vlerë prej (9,480,000 €) .

Planifikimi i Buxhetit Komunal për vitin 2016 është 40,576,574 € për vitin 2017 parashikohet të jetë 40,647,197 € kurse për vitin 2018 parashikohet shuma 40,977,318 €

		Parashikimii 2017	Parashikimi 2018
Granti i përgjithshëm	Administrata	13,331,400	13,661,521
	Arsimi	13,632,521	13,632,521
	Shëndetësia	4,203,276	4,203,276
<b>Subtotali</b>		<b>31,167,197</b>	<b>31,497,318</b>
Të hyrat vetjake Komunale	Administrata	9,030,000	9,030,000
	Arsimi	250,000	250,000
	Shëndetësia	200,000	200,000
<b>Subtotali</b>		<b>9,480,000</b>	<b>9,480,000</b>
<b>Buxheti Komunal prej dy burimeve</b>		<b>40,647,197</b>	<b>40,977,318</b>

## TË DALAT E BUXHETIT KOMUNAL 2016

Pasi Buxheti Komunal përbëhet prej tre programeve kryesore funksionale atëherë edhe Buxheti Komunal do të shpalojë veçmas për çdo program:

- A. Buxheti i Administratës përgjithshme,
- B. Buxheti i Arsimit,
- C. Buxheti i Shëndetësisë.

Të dalat e Buxhetit Komunal i kemi kategorizuar në pesë grupe :

- Pagat dhe mëditjet
- Mallrat dhe shërbimet ,
- Shpenzimet komunale,
- Subvencionet dhe transferet
- Investimet kapitale

### TË DALAT E BUXHETIT FINAL KOMUNAL PËR VITIN 2016

		Të dalat e Buxhetit Komunal			
		Aprovimi 2015	planifikimi 2016	%	Ind
<b>Pagat</b>	Administrata	2,013,268	2,299,733		
	Arsimi	12,576,316	12,786,063		
	Shëndetësia	3,148,628	3,305,326		
<b>Subtotali</b>		<b>17,738,212</b>	<b>18,391,122</b>	<b>45</b>	<b>104</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	Administrata	1,493,881	1,731,125		
	Arsimi	795,154	795,154		
	Shëndetësia	611,790	590,790		
<b>Subtotali</b>		<b>2,900,825</b>	<b>3,117,069</b>	<b>8</b>	<b>107</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	Administrata	769,199	739,199		
	Arsimi	212,001	212,001		
	Shëndetësia	100,000	130,000		
<b>Subtotali</b>		<b>1,081,200</b>	<b>1,081,200</b>	<b>3</b>	<b>100</b>
<b>Subvencionet</b>	Administrata	580,979	477,615		
	Arsimi	-	-		
	Shëndetësia	-	-		
<b>Subtotali</b>		<b>580,979</b>	<b>477,615</b>	<b>1</b>	<b>82</b>
<b>Investimet kapitale</b>	Administrata	14,664,724	15,270,408		104
	Arsimi	1,862,000	1,862,000		
	Shëndetësia	542,858	377,160		
<b>Subtotali</b>		<b>17,069,582</b>	<b>17,509,568</b>	<b>43</b>	<b>103</b>
<b>Totali</b>		<b>39,370,798</b>	<b>40,576,574</b>	<b>100</b>	<b>103</b>

Me parashikimin e Buxhetit Komunal për vitin 2016 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është parashikuar të ndahet shuma prej 18,391,122 € ose 652.910 € më shumë se në vitin buxhetor 2015 (17,738,212 €). Me këtë shumë parashihet të sigurohen pagat për 3101 të punësuarve të Administratës Komunale si dhe pagesat e shtesave të asambleistave dhe puna jashtë orarit në Administratën Lokale. Këto të dala marrin pjesë me 45 % në shumën totale të buxhetit komunal. Pagat për vitin 2017 **18,391,122 €** dhe 2018 **18,391,122 €**

Për kategorinë mallra dhe shërbime për vitin 2015 ka qenë e planifikuar shuma prej 2,900,825 € kurse për vitin 2016 parashikohet shuma prej 3,117,069 € ose shënon një rritje për 7 %. Kurse për vitin 2017 3,117,069 € dhe 2018 (3,117,069 €).

Për kategorinë e Shpenzimeve Komunale për vitin 2015 ka qenë e ndarë shuma prej 1,081,200 € kurse për vitin 2016 është planifikuar shuma prej 1,081,200 € për 2017 1,081,200 €, ndërsa për 2018 është parashikuar shuma prej 1,081,200 €.

Në kategorinë e subvencioneve dhe transferëve shuma e planifikuar për vitet 2016-2018 është **477,615 €**.

Për realizimin e projekteve kapitale të projektuara në nivel të Komunës për vitin 2016 janë planifikuar 17,509,568 € ose **439.986 €** më shumë se në vitin fiskal 2015.

Për vitin 2017 është parashikuar shuma prej **17,580,191 €** dhe për vitin 2018 është **17,910,312 €**.

Totali i të dalave të parashikuara të buxhetit komunal për vitin 2016 është prej **40,576,574 €** ose 3 % më shumë në krahasim me atë të vitit 2015. (**39,370,798 €**), ndërsa për vitin 2017 është **40,647,197 €** dhe **40,977,318 €** për 2018

### **TË DALAT E BUXHETIT 2017-2018**

		<b>Parashikimi 2017</b>	<b>Parashikimi 2018</b>
<b>Pagat</b>	Administrata	2,299,733	2,299,733
	Arsimi	12,786,063	12,786,063
	Shëndetësia	3,305,326	3,305,326
	<b>Subtotali</b>	<b>18,391,122</b>	<b>18,391,122</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	Administrata	1,731,125	1,731,125
	Arsimi	795,154	795,154
	Shëndetësia	590,790	590,790
	<b>Subtotali</b>	<b>3,117,069</b>	<b>3,117,069</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	Administrata	739,199	739,199
	Arsimi	212,001	212,001
	Shëndetësia	130,000	130,000
	<b>Subtotali</b>	<b>1,081,200</b>	<b>1,081,200</b>
<b>Subvencionet</b>	Administrata	477,615	477,615
	Arsimi	0	0
	Shëndetësia	0	0
	<b>Subtotali</b>	<b>477,615</b>	<b>477,615</b>
<b>Investimet kapitale</b>	Administrata	15,341,031	15,671,152
	Arsimi	1,862,000	1,862,000
	Shëndetësia	377,160	377,160
	<b>Subtotali</b>	<b>17,580,191</b>	<b>17,910,312</b>
<b>Totali</b>		<b>40,647,197</b>	<b>40,977,318</b>

## A. BUXHETI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME 2016-2018

### TË HYRAT E BUXHETIT TË ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME 2016

	Aprovimi 2015	Planifikimi 2016	%	Ind
Granti i Adm. Lokale	14,356,806	13,260,777	59	92
Të HV	7,825,080	9,030,000	41	115
<b>Totali</b>	<b>22,181,886</b>	<b>22,290,777</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

### TË HYRAT E BUXHETIT TË ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME 2017-2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
Granti i Adm. Lokale	13,331,400	13,661,521
Të HV	9,030,000	9,030,000
<b>Totali</b>	<b>22,361,400</b>	<b>22,691,521</b>

Nga pasqyra e mësipërme shihet se Granti i Administratës së përgjithshme i parashikuar për vitin 2016 në një shumë prej **13,250,777 €**

Ky Grant merr pjesë me 60 % në totalin e buxhetit të Administratës Lokale.

Granti i Administratës së përgjithshme për vitin 2017 parashihet të jetë **13,331,400 €**dhe **13,661,521 €**në 2018.

Të Hyrat vetjake të Buxhetit të Administratës e përgjithshme për vitin fiskal 2016 parashihet të grumbullohen në një shumë prej **9,030,000 €**dhe këto të hyra marrin pjesë me 41 % në totalin e të Hyrave të Buxhetit.

Të Hyrat Vetjake për vitin fiskal 2017 parashihet të jenë **9,030,000 €** kurse për vitin 2018 planifikohet shuma prej **9,030,000 €**

Buxheti total i Administratës e përgjithshme për vitin 2016 parashihet të jetë **22,290,777 €** do të thotë 7 % më i lartë në krahasim me planifikimin e vitit 2015 ( **20,841,944 €**).

Buxheti total i Administratës e përgjithshme për vitin 2017 parashihet të jetë **22,361,400 €** dhe për vitin 2017 në shumë prej **22,691,521 €**

## STRUKTURA E TË DALAVE TË ADMINISTRATËS 2016-2018

### Të dalat e buxhetit final të Administratës Lokale 2016

	Aprovimi 2015	Planifikimi 2016	%	Ind
Pagat (Adm. Lok.)	2,013,268	2,299,733	11	114
Mallrat dhe shërbimet	1,493,881	1,731,125	8	116
Shpenz.komunale	769,199	739,199	4	96
Subvencionet	580,979	477,615	2	82
Investimet kapitale	14,664,724	15,270,408	74	104
<b>Totali</b>	<b>19,522,051</b>	<b>20,518,080</b>	<b>100</b>	<b>105</b>

### Të dalat e buxhetit final të Administratës Lokale 2017-2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
Pagat (Adm. Lok.)	2,299,733	2,299,733
Mallrat dhe shërbimet	1,731,125	1,731,125
Shpenz.komunale	739,199	739,199
Subvencionet	477,615	477,615
Investimet kapitale	15,341,031	15,671,152
<b>Totali</b>	<b>20,588,703</b>	<b>20,918,824</b>

Pagat për stafin e Administratës Lokale e përbëjnë grupin e parë të dalave. Për vitin 2016, këto të dala janë parashikuar në lartësi prej **2,299,733 €** dhe përfshijnë 11 % të dalave të buxhetit.

Shuma e planifikuar për kategorinë e pagave për vitin 2017 **2,299,733 €** dhe **2,299,733 €** për vitin 2018.

Planifikimi i shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2016 - 2018 është **1,731,125 €**.

Shpenzimet Komunale të Administratës Lokale për vitin 2016 janë paraparë të jenë në shumë prej **739,199 €**, ose 4% më pak se në vitin 2015 (**769,199 €**). Për vitin 2017 **739,199 €** për vitin 2018 është parashikuar vlera e njëjtë prej **739,199 €**

Në kategorinë e subvencioneve shuma e planifikuar për vitet 2016 -2018 është **477,615 €**

Realizimi i projekteve kapitale në vitin 2016 ( **15,270,408 €**) planifikohet të jetë më i lartë për **605.684 €** në krahasim me vitin 2015 ( **14,664,724 €**).

Shuma për investime kapitale në vitin 2017 parashihet të jetë **15,341,031 €** dhe në vitin 2018 ( **15,671,152 €** ).

Struktura e të punësuarve në Administratën e përgjithshme është si vijon:

Administrata e përgjithshme	376	të punësuar
Arsimi	2250	të punësuar
Shëndetësia	475	të punësuar
	<hr/>	
	3101	të punësuar



## B. BUXHETI I ARSIMIT

### TË HYRAT E BUXHETIT TË ARSIMIT 2016

	Aprovimi 2015	Planifikimi 2016	%	Ind
Granti i Arsimit	12,535,636	13,632,521	98	109
Të HV	250,000	250,000	2	
<b>Totali</b>	<b>12.785.636</b>	<b>13,882,521</b>	100	98

### TË HYRAT E BUXHETIT TË ARSIMIT 2017- 2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
Granti i Arsimit	13,632,521	13,632,521
Të HV	250,000	250,000
<b>Totali</b>	<b>13,882,521</b>	<b>13,882,521</b>

Nga Buxheti Qendror i Kosovës, si Grant Qeveritar, për vitin 2016 Arsimit i janë ndarë mjete në shumë prej **13,632,521€**

Me planifikimin për vitin 2017 parashihet shuma **13,632,521 €** ndërsa për 2018 është **13,632,521 €**

Të hyrat vetjake për vitin fiskal 2016-2018 parashihet të jenë **250.000 €**

Buxheti total i Arsimit për vitin 2016 parashihet të jetë **13,882,521€**  
Ndërsa për vitin 2017 do të jetë **13,882,521 €** dhe **13,882,521 €** për vitin 2018.

## TË DALAT E BUXHETIT TË ARSIMIT 2016

	Aprovimi 2015	Planifikimi 2016	%	Ind
<b>Pagat</b>	<b>12,576,316</b>	<b>12,786,063</b>	<b>82</b>	<b>102</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	<b>795,154</b>	<b>795,154</b>	<b>5</b>	<b>100</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	<b>212,001</b>	<b>212,001</b>	<b>1</b>	<b>100</b>
<b>Subvencionet</b>				
<b>Mjetet për invest. kapitale</b>	<b>1,862,000</b>	<b>1,862,000</b>	<b>12</b>	<b>100</b>
<b>Totali</b>	<b>15,445,471</b>	<b>15,655,218</b>	<b>100</b>	<b>101</b>

## TË DALAT E BUXHETIT TË ARSIMIT 2017-2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
<b>Pagat</b>	<b>12,786,063</b>	<b>12,786,063</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	<b>795,154</b>	<b>795,154</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	<b>212,001</b>	<b>212,001</b>
<b>Subvencionet</b>		
<b>Mjetet për invest. kapitale</b>	<b>1,862,000</b>	<b>1,862,000</b>
<b>Totali</b>	<b>15,655,218</b>	<b>15,655,218</b>

Nga tabela e mësipërme shihet se pjesa më e madhe e buxhetit të Arsimit (82 %) parashihet të shpenzohet për pagat e stafit prej 2.250 të punësuarve. Për vitin 2016 për pozicionin e Pagave është paraparë shuma prej **12,786,063€**

Në tabelën e mësipërme shihet se shuma e planifikuar për paga do të mbetet e njëjtë edhe për vitet 2017-2018.

Pozicioni për Mallra dhe Shërbime planifikimi për vitet 2016-2018 është **795,154 €**

Në kategorinë e Shpenzimeve Komunale për vitet 2016-2018 është parashikuar shuma në vlerë prej **212,001 €**

Pozicioni i mjeteve për Investime kapitale për vitin 2016-2018 është **1,862,000 €**

## C. BUXHETI I SHËNDETËSISË

### TË HYRAT E BUXHETIT TË SHËNDETËSISË 2016

	Aprovimi 2015	Planifikimi 2016	%	Ind
<b>Granti i Shëndetësisë</b>	<b>4,203,276</b>	<b>4,203,276</b>	<b>95</b>	<b>100</b>
<b>Të HV</b>	<b>200,000</b>	<b>200,000</b>	<b>5</b>	<b>100</b>
<b>Totali</b>	<b>4,403,276</b>	<b>4,403,276</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

### TË HYRAT E BUXHETIT TË SHËNDETËSISË 2017-2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
<b>Granti i Shëndetësisë</b>	<b>4,203,276</b>	<b>4,203,276</b>
<b>Të HV</b>	<b>200,000</b>	<b>200,000</b>
<b>Totali</b>	<b>4,403,276</b>	<b>4,403,276</b>

Nga Buxheti Qendror i Kosovës, si Grant Qeveritar për vitin 2016, Shëndetësisë Primare i janë ndarë mjete në shumë prej **4,203,276 €** Burimi i dytë i të hyrave të Buxhetit të Shëndetësisë Primare janë të Hyrat Vetjake që sigurohen prej participimit. Këto të Hyra, për vitin 2016-2018 parashikohet të realizohen në një shumë prej 200.000 € dhe pjesëmarrja e tyre në përbërjen e këtij buxheti është 5 %.

Për Shëndetësinë Primare shuma totale e Buxhetit të parashikuar për vitin 2016 është **4,403,276€**

Në vitin 2017 - 2018 parashikohet të jetë **4,403,276 €**.

## TË DALAT E BUXHETIT TË SHËNDETËSISË 2016

	2015	Planifikimi 2016	%	Ind
<b>Pagat</b>	<b>3,148,628</b>	<b>3,305,326</b>	<b>75</b>	<b>105</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	<b>611,790</b>	<b>590,790</b>	<b>13</b>	<b>97</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	<b>100,000</b>	<b>130,000</b>	<b>3</b>	<b>130</b>
<b>Subvencionet</b>			-	
<b>Mjetet për invest. kapitale</b>	<b>542,858</b>	<b>377,160</b>	<b>9</b>	<b>69</b>
<b>Totali</b>	<b>4,403,276</b>	<b>4,403,276</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

## TË DALAT E BUXHETIT TË SHËNDETËSISË 2017-2018

	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
<b>Pagat</b>	<b>3,305,326</b>	<b>3,305,326</b>
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	<b>590,790</b>	<b>590,790</b>
<b>Shpenz.komunale</b>	<b>130,000</b>	<b>130,000</b>
<b>Subvencionet</b>		
<b>Mjetet për invest. kapitale</b>	<b>377,160</b>	<b>377,160</b>
<b>Totali</b>	<b>4,403,276</b>	<b>4,403,276</b>

Për vitin fiskal 2016 për kategorinë e Pagave të stafit prej 475 të punësuarve të Shëndetësisë Primare është paraparë shuma prej **3,305,326 €** ose 75 % e totalit të Buxhetit të Shëndetësisë Primare.

Për vitin 2017-2018 planifikohet shuma e njëjtë prej **3,305,326 €**

Për Mallra dhe Shërbime për vitin 2016-2018 janë parashikuar **590,790 €**  
Në kategorinë e Shpenzimeve Komunale për vitet 2016-2018 është parashikuar shuma prej **130,000 €**

Parashikimi i Investimeve Kapitale për 2016-2018 është **377,160 €**,

Këto të Dala marrin pjesë me 9 % në totalin e të Dalave të Buxhetit Shëndetësisë Primare të parashikuar për vitet 2016- 2018.

Buxheti total i Shëndetësisë në vitin 2016-2018 parashihet të jetë **4,403,276 €**.